

Melanie Friend në emisionin "Everywoman", të BBC-së

Libri me fotografi dhe dëshmi nga Kosova

Një kosovar i kishte thënë asaj: "Kurrë nuk është aq vonë për të bërë diçka të mirë" duke shtuar se "vdekja na është afruar më tepër se ajo këmishë që e ke veshur ti"

LONDER, (BBC) - Shumë kohë para se Kosova të ishte nëpër kryetituj, fotoreporterja britanike Melanie Friend ka shkelur në këtë rajon. Tash përmes 75 fotografive me ngjyra, të shoqëruara nga 50 dëshmi personale, libri i saj "No Place Like Home: Echoes From Kosovo" shpreh situatën e brendshme të pasojave të luftës në njerëz.

Duke folur në emisionin e BBC-

së "Everywoman", Friend shpjegon se si i sfidon konvencat e fotografatarisë.

Pa konvenca

Ajo nuk e kishte përcjellë traditën e zakonshme të fotografisë në luftë. "Ato janë më formale, janë stil i studio-portretit", tha ajo. "Unë me të vërtetë mendoja se duhet t'u jepet rasti njerëzve të jenë të nderuar, ta kenë një

lloj të autonomisë, një lloj të vetëkontrollit. Kjo më dukej më mirë se t'i fotografoja atëherë kur janë duke e kaluar kufirin duke qarë, në kohën kur me të vërtetë janë në majën e traumave".

Dëshmia

Në vitin 1999, NATO i dërgoi aeroplanët luftarakë në Jugosllavi për të detyruar Beogradin dhe liderin e atëherëshëm, Slobodan Milosheviq, që të ndalë "pastrimin etnik" të popullatës shqiptare në Kosovë. Gjatë kohës së konfliktit 640,000 civilë u dëbuan nga shtëpitë e tyre duke u vendosur në vende më të sigurta, në kampet e refugjatëve në shtetet fqinje Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Gjatë kësaj kohe Melanie Friend vendosi të kthehet në këtë regjion për ta kuptuar ngjarjen e disa njerëzve të cilët i kishte zënë lufta.

Situata ishte shumë e tensionuar, dhe shumë njerëz flis-

nin për dëmet që do të mbesin të pashlyeshme edhe në të ardhmen.

Një kosovar i kishte thënë asaj: "Kurrë nuk është aq vonë për të bërë diçka të mirë", duke shtuar se "vdekja na është afruar më tepër se ajo këmishë që e ke veshur ti".

Vendlindja

Fotografite e këtij libri i fusin njerëzit në këtë kontekst. Ata në të shumtën janë të fotografuar në shtëpitë e tyre, me gjërat që u përkisnin dhe me fotografite familjare në prapavijë.

Kjo atmosferë familjare sjell një kontrast të fortë me tregimet mbi terrorin.

Friend shpjegon: "E kam ndier veten shumë të obliguar duke i dëgjuar njerëzit se si flisnin për frikën e tyre, duke ndenjur në dhomat e shtëpive të tyre dhe duke mos parë asnjë pikë shprese... Në kohën kur unë isha atje, shumë shpesh nuk kishte asgjë për të parë".

"Unë nganjëherë dëgjoja




Vlora dhe Fatjoni të dy trevjeçarë - në kampin e Neproshtenit

tregime nga familjet të cilat ishin të lëna dhe isha shumë e shokuar nga diferenca e asaj që dëgjoja dhe shihja".

Ajo shtoi: "U ndjeva paksa e frikësuar nga fakti se shtëpia nuk ishte vend i sigurt, ajo mund të sulmohej në çdo kohë nga stacioni i policisë".

Shënimet janë të përshkruara tamam siç ka thënë Friend: "Sensi i së përgjithshmes...ajo që është me rëndësi është ajo së cilës të intervistuarit i besojnë". Më vonë këtë vit Friend planifikon të kthehet në rajon. "Do të kthehem me valixhe të mbushura me libra dhe do t'ua dërgoj ato atyre që janë në faqet e këtyre librave".

"Ndoshta do të jetë interesant për ata që ta shohin vetveten".



Lutfiye Pllana dhe mbesa e saj katërvjeçare në kampin e Neproshtenit